



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 68, datë 5.4.2019

PËR

**MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS
SË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME DHE DREJTORIVE
RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Struktura e Drejtorisë Qendrore të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Organika e Drejtorisë Qendrore të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar të jetë sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Struktura e drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar Durrës, Fier, Lezhë dhe Korçë të jetë sipas skemës 1/1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
4. Organika e drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar Durrës, Fier, Lezhë dhe Korçë të jetë sipas skemës 2/1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
5. Numri i punonjësve të Drejtorisë Qendrore të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar të jetë, gjithsej, 21 veta.

6. Numri i punonjësve të drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar të jetë, gjithsej, 60 veta.


7. Urdhri nr.199, datë 1.12.2010, i Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së drejtorive arsimore rajonale dhe zyrave vendore”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

STRUKTURA E DREJTORISË QENDRORE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR



**ORGANIKA E DREJTORISË QENDRORE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR**

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
1		
TITULLAR I INSTITUCIONIT	II-a	1
SEKRETAR		1
2		
SEKTORI I KURRIKULËS DHE ZHVILLIMIT PROFESIONAL		6
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	5
3		
SEKTORI I INSPEKTIMIT, MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT TË CILËSISË		7
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	6
4		
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE, SHËRBIMEVE DHE STATISTIKËS		6
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST (PËR BURIMET NJERËZORE)	IV-a	1
SPECIALIST (PËR INVESTIMET DHE INFRASTRUKTURËN)	IV-a	1
SPECIALIST (PËR FINANCËN DHE BUXHETIN)	IV-a	1

POZICIONI

KATEGORIA

NUMRI

SPECIALIST (JURIST)

IV-a

1

SPECIALIST (STATISTIKE)

IV-a

1


PUNONJËS GJITHSEJ

21

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

STRUKTURA E DREJTORIVE RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, DURRËS, FIER, LEZHË DHE KORÇË



**ORGANIKA E DREJTORIVE RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, DURRËS, FIER, LEZHË DHE
KORÇË**

	POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
1	DREJTOR	III-b	1
	SEKRETAR		1
2	SEKTORI I KURRIKULËS DHE ZHVILLIMIT PROFESIONAL		4
	PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-a	1
	SPECIALIST	IV-b	3
3	SEKTORI I INSPEKTIMIT DHE VLERËSIMIT TË CILËSISË		4
	PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-a	1
	SPECIALIST	IV-b	3
4	SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE, SHËRBIMEVE DHE STATISTIKËS		5
	PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-a	1
	SPECIALIST (PËR BURIMET NJERËZORE)	IV-b	1
	SPECIALIST (PËR INVESTIMET DHE INFRASTRUKTURËN)	IV-b	1

POZICIONI

KATEGORIA

NUMRI

SPECIALIST (PËR FINANCËN DHE BUXHETIN)

IV-b

1

SPECIALIST (STATISTIKE)

IV-b

1

PUNONJËS GJITHSEJ

15

NUMRI I PUNONJËSVE NË TË GJITHA DREJTORITË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DO TË JETË GJITHSEJ 60

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

NR.PROT.1607/2
DATË 5.4 2019

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR
DREJTORIVE RAJONALE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR DURRËS, FIER, LEZHË DHE
KORÇË
DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

